

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME

AGJENCIA E ADMINISTRIMIT TË PASURIVE TË SEKUESTRUARA DHE
KONFISKUARA

Nr. 508 Prot

Tiranë, 05.02.2024

Lënda : Kërkesë për ndryshimin e Administratorit.

QENDRËS KOMBETARE TË BIZNESIT

Adresa :Bulevardi "Zhan D'Ark", Prona nr. 33, Shtëpia e Ushtarakëve

Tiranë

Në zbatim të ligjit 10192 datë 3.12.2009 i ndryshuar me ligjin Nr.70/2017 "Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar, Trafikimit, Korrupsionit dhe Krimeve të tjera, Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë", si dhe në zbatim të Vendimit Nr. 46, datë 22.01.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, e cila ka vendosur sekuestrimin e pasurive, si më poshtë :

1. Shoqërinë tregtare shqiptare "Globalsher" shpk me NIPT L62120029D dhe asetet e saj , me ortak të vetëm personin nën hetim Ilir Rrapaj.
2. Pjesa takuese 40% e shoqërisë "SaniService" shpk , me NIPT L51910021C, që i korrespondon në bashkimin e kompanive që kanë krijuar shoqërinë SaniService Shpk

Për sa më sipër, në zbatim të Urdhërit nr. 69, dt. 01.02.2024 të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara, kërkojmë nga ana juaj caktimin e Administratorit Z. Enea Caushaj.

Bashkëlidhur :

- Urdhëri nr. 69, dt. 01.02.2024 i AAPSK mbi ndryshimin e Administratorit. (fotokopje e njehësuar)
- Fotokopje e Kartës ID të Administratorit.
- Vendimi nr. . 46, datë 22.01.2024 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. (fotokopje e njehësuar)

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

KRYEADMINISTRATOR

Adrian Koni

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

ADMINISTRATOR

Musa Hyka





REPUBLIKA E ALBANI
MINISTRIA E BRENDSHME

AGJENCIA E ADMINISTRIMIT TË PASURIVE TË SEKUESTRUARA DHE KONFISKUARA

Nr. 482/17 Prot.

Tiranë, më 01.02.2024

URDHËR

Nr. 65, Datë 01.02.2024

PËR

EMËRIMIN E ADMINISTRATORIT PËR PASURITË E SEKUESTRUARA DHE TË KONFISKUARA

Në mbështetje të Ligjit nr. 10192, dt. 3.12.2009 i ndryshuar "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", Ligjit nr. 34/2019, i ndryshuar "Për Administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara".

URDHËROJ:

I-Emërimin e Z.Enea Çaushaj si administrator të pasurive së sekuestruara me vendimin nr.46, datë 22.01.2024, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, konkretisht:

1-Pjesa takuese 40% e shoqërisë "Sani Service"sh.p.k me NIPT L51910021C, që i korespondon në bashkimin e kompanive që kanë krijuar shoqërinë Sani Service sh.p.k.

2-Subjektin tregtar "Investital Llc," Investitali" shoqëri e së drejtës kosovare,regjistruar pranë Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë, me numër fiskal 60113807, me administrator të vetëm personin nën hetim Ilir Rrapaj.

3-Shoqërinë tregëtare shqiptare "Globalsher" sh.p.k me NIPT L6220029D dhe asetet e saj, me ortak të vetëm personin nën hetim Ilir Rrapaj.

II- Ngarkohet për zbatimin e këtij Urdhri Sektori i Administrimit Ekonomiko-Financiar të Pasurive.

III-Afati deri më datë 15.02.2024.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.


KRYEADMINISTRATOR

Adrian Koni

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

ADMINISTRATOR

Mirza Hyka





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË PËR KORRUPSIONIN DHE
KRIMIN E ORGANIZUAR

NR. 46 AKTI

Datë 22.01.2024

Y E N D I M

"NË EMËR TË REPUBLIKËS"

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë prej:

GJYQTAR: ERJON BANI

Me pjesëmarrjen e sekretares gjyqësore Enkelelda Luga, në Tiranë, sot më datë 22.01.2024, pasi mori në shqyrtimin në seancë gjyqësore, çështjen penale me Nr. 46 Akti, me palë:

KËRKUES:

Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, përfaqësuar nga prokurorët **Edvin Kondili dhe Fined Nakuçi**.

Objekti:

1. Caktimin e masës së sigurimit pasuror, sekuestro preventive, për shoqëritë tregtare dhe të gjitha asetet e shoqërive tregtare, të përshkruara si më poshtë:

- 1) Pjesa takuese prej 40 % e shoqërisë "SaniService" sh.p.k, me NIPT L51910021C, që i korrespondon në bashkimin e kompanive që kanë krijuar shoqërinë Sani Service sh.p.k;
- 2) Subjektin tregtar "Investital Llc, "Investital" shoqëri e së drejtës kosovare, regjistruar pranë Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë, me numër fiskal 60113807, me administrator të vetëm personin nën hetim Ilir Rrapaj;
- 3) Shoqërinë tregtare shqiptare "Globalsher" sh.p.k me NIPT L6220029D dhe asetet e saj, me ortak të vetëm personin nën hetim Ilir Rrapaj.

2. Për administrimin dhe përdorimin e pasurive të sekuestruara të ngarkohet Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara Tiranë.

3. Të ngarkohet me ekzekutimin e këtij vendimi, policia gjyqësore në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara

Baza ligjore:

Neni 274 i Kodit të Procedurës Penale si dhe nenet 4 pika "c" dhe 11 të Ligjit Nr. 34/2019 "PËR ADMINISTRIMIN E PASURIVE TË SEKUESTRUARA E TË KONFISKUARA".

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar i është drejtuar Gjykatës me kërkesë me objekt: Caktimin e masës së sigurimit pasuror, sekuestro preventive mbi shoqëritë tregtare që janë në zotërim të personit nën hetim Ilir Rrapaj.

2. Shqyrtimi i kësaj kërkesë u zhvillua në prani të prokurorisë dhe në një seancë me dyer të mbyllur për shkak të karakterit sekret deri në ekzekutimin e masës së sigurimit.

3. Nga aktet e prokurorisë rezulton se, Prokuroria Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar Tiranë, mbi bazën e kallëzimit penal të kryer nga subjekti: Nisma Thurje me Nr. 8, datë 24.12.2019, më datë 13.01.2020 ka regjistruar procedimin penal nr. 13 viti 2020, për veprat penale "Shpërdorimi i detyrës", e kryer në bashkëpunim, "Shkelje e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankunde publike", në bashkëpunim, "Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë" të parashikuara nga nenet 248-25, 258-25 dhe 260 të Kodit Penal.

4. Në kallëzimin e paraqitur nga Nisma Thurje, protokolluar pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar me Nr. 97 Prot., datë 23.12.2019 paraqiten faktet si më poshtë vijon: [...]

Bazuar në Nenet 280 dhe 283 të Kodit të Procedurës Penale, kërkojmë nisjen e hetimit penal për zyrtarët e përfshirë në dëntion me koncesion të një shërbimi publik, pasi dyshojmë se jemi përpara konsumimit të veprave penale nga zyrtarët e lartë publik.

Me datë 10 Dhjetor 2015 Ministria e Shëndësisë, me miratimin e Ministrisë së Financave dhe KPP, ka lidhur një kontratë koncesionare me kompaninë "San i Service" L519 I 0021 C me objekt: Dhënie me koncesion "Për shërbime të integruara për ofrimin e setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale, furnizimin me material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, si dhe trajtimin e mjetëve biologjike dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale".

Nisur nga kontrata e bërë publike, sidhe bazuar në raportet e institucioneve dhe publikimet e medias, kemi shqetësimet e mëposhtme:

Së pari, kemi dyshime për nevojën e marrjes së këtij shërbimi nga njëpalë e tretë në kushtet kur ai kryhej prej dekadash nga vetë spitalet publike. Kjo bëhet veçanërisht shqetësuese nëse spitalet i kanë ende në gjëndje pune autoklavat e tyre, dhe nëse

personale për t'i gëzuar pasuritë e sekuestruara. 3. Kur masa e sekuestrimit caktohet ndaj pasurisë së regjistruar, administratori i emëruar njofton menjëherë këtë masë në zyrat pranë të cilave mbahen këta regjistru. 4. Kur sendi mbahet pa titull pronësie ose në bazë të një titulli që daton përpara datës së vendimit të sekuestrimit dhe poseduesi i sendit nuk pranon ta dorëzojë atë vullnetarisht, gjykata urdhëron lirin e sendit. Urdhri i gjykatës ekzekutohet nga Policia Gjyqësore. 5. Inventari dhe përshkrimi i pasurisë së sekuestruar bëhen nga Policia Gjyqësore dhe dokumentohen në një raport, i cili nënshkruhet nga administratori i pasurisë së sekuestruar dhe oficeri i Policisë Gjyqësore, si dhe, sipas rastit, nga të pranishëm të tjerë. Ky raport përmban elementet e parashikuara nga Kodi i Procedurës Civile. 6. Gjatë marrjes në dorëzim të pasurisë së sekuestruar nga administratori, Policia Gjyqësore u dorëzon një kopje të raportit të përmendur në pikën 5, të këtij neni, personave të pranishëm në kohën e inventarit. 7. Në rastin e marrjes në dorëzim të pasurisë dhe të kuotave e aksioneve të shoqërive tregtare të regjistruara në regjistrin e shoqërive tregtare, Policia Gjyqësore dorëzon pasurinë e sekuestruar tek administratori, të shoqëruar me dokumentacionin përkatës ligjor dhe, nëse ka, edhe me regjistrat e llogarive të shoqërisë tregtare. 8. Administratori i pasurisë, për qëllime të administrimit dhe në mungesë të dokumentacionit të parashikuar në pikën 7, të këtij neni, vë në dispozicion të audituesit ligjor, të caktuar nga kryeadministratori, për të vënë në dispozicion të dhënat e nevojshme për administrimin e pasurisë, duke i kërkuar hartimin e një raporti. Raporti vihet në dispozicion të Agjencisë. Nga përmbajtja e kësaj dispozite rezultoi se me ekzekutimin e vendimit të gjykatës për sekuestron preventive ngarkohet policia gjyqësore dhe administratori, ku ky i fundit kur masa e sekuestrimit caktohet ndaj pasurisë së regjistruar, njofton menjëherë këtë masë në zyrat pranë të cilave mbahen këta regjistru, si regjistri tregtar, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoritë e Transportit Rrugor, organet informore etj.

164.2. Ndodhur në këto kushte, Gjykata çmon se, për administrimin e pasurive të sekuestruara ngarkohet Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata, në bazë dhe për zbatim të nenev 103, 274-276 të K.Pr.Penale, si dhe në nenet 4 gërma "c", 11 dhe 16 të Ligjit Nr. 34/2019 "PËR ADMINISTRIMIN E PASURIVE TË SEKUESTRUARA E TË KONFISKUARA", i ndryshuar me Ligjin Nr. 19/2020

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.
2. Caktimin e masës së sigurimit pasuror, sekuestro preventive mbi këto pasuri:

- 1) Pjesa takuese prej 40 % e shoqërisë "SaniService" sh.p.k, me NIPT L51910021C, konkretisht kuota që i përket subjektin tregtar "Investital Llc, në zbatim të Kontratës "Për bashkimin e përkohshëm të shoqërive" Nr. 598 Rep., dhe Nr. 287 Kol., datë 04.03.2015,⁴² e lidhur midis: 1)

⁴² Në pikën 4 të kësaj Kontrate, nën titullin "Kuotat e Pjesëmarrjes", parashikohet shprehimisht se: "Pjesëmarrja e Anëtarëve në BPSH është si në vijim: Investital me një kuota pjesëmarrje prej 40,0% (dyzet përqind); Servizi Italia me një kuota pjesëmarrje prej 30,0% (tridhjetë përqind); Tecnosanimed me një kuota

Investital Llc, me përfaqësues z.Illir Rrapaj; 2) Servizi Italla S.p.A, me përfaqësues z.Fnca Righi; 3) Tecnosanimed S.r.L, me përfaqësues z.Umbro Staccini; 4) U.Jet S.r.l, me përfaqësues z.Umbro Staccini;

2) Subjektin tregtar "Investital Llc, "Investitali" shoqëri e së drejtës kosovare, regjistruar pranë Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë, me numër fiskal 60113807, me administrator të vetëm personin nën hetim Ilir Rrapaj;

3) Shoqërinë tregtare shqiptare "Globalsher" sh.p.k me NUIS L62120029D, datë regjistrimi 20.09.2016 dhe asetet e saj, me ortak të vetëm personin nën hetim Ilir Rrapaj.

3. Ngarkohet Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar në bashkëpunim me hetuesit e Byrosë Kombëtare të Hetimit, hetuesit e Seksionit Financiar, të mbështetur nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, për ekzekutimin e këtij vendimi.


4. Për Administrimin e pasurive sipas pikës 2 të dispozitivit të këtij vendimi ngarkohet Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara.

5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 10 (dhjetë) ditëve në Gjykatën e Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar nga e nesërmitja e njoftimit të këtij vendimi prokurorisë ose nga nga dita që i interesuari ka marrë dijeni për sekuestron e vënë.

U shpall sot në Tiranë, më datë 22.01.2024

SEKRETARE

ENKELEIDA LUGA



GJYQTAR

ERJON BANI



pjesëmarrje prej 15,0% (pesëmbëdhjetë përqind); dhe Ujet me një kuota pjesëmarrje prej 15,0% (pesëmbëdhjetë përqind)."